



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010), nenin 4, paragrafi 3 dhe nenit 39, paragrafi 5 i Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2016 miratoi si në vijim:

RREGULLORE PËR DELEGIMIN E FUNKSIONEVE TË SIGURUESVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kushteve dhe kritereve për delegimin e funksioneve të siguruesit tek një person tjetër (pranuesi i funksioneve të deleguara).
2. Kjo Rregullore aplikohet për të gjithë Siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm, të licencuara nga BQK-ja, për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë siç janë përcaktuar në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet (më tutje (Ligji për Sigurimet) dhe /ose siç përcaktohet me poshtë për qëllimet e kësaj rregulloreje.
 - a) Pranuesi i funksioneve të deleguara, nënkupton personin fizik apo juridik, tek i cili siguruesi mund t'i delegoj funksionet e tij sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
2. Për qëllime të kësaj rregullore, përveç nëse është specifikuar ndryshe me dispozita të veçanta, me termin “Sigurues”, nënkuptohet edhe dega e siguruesit të jashtëm

Neni 3

Delegimi i Funksioneve

1. Sipas nenit 39 të Ligjit për Sigurimet, siguruesi mund të delegojë funksionet që lejohet të delegohen sipas kësaj rregulloreje, tek pranuesi i funksioneve të deleguara, vetëm pasi të ketë marrë miratimin paraprak me shkrim nga BQK-ja;
2. Siguruesit mund të delegojnë funksionet e mëposhtme:
 - a) trajtimi dhe vlerësimi i dëmeve, të licencuara nga BQK-ja;
 - b) shërbimet aktuariale, të licencuara nga BQK-ja;
 - c) shërbimet e promovimit dhe marketingut;
 - d) shërbimet e teknologjisë informative;

- e) mbajtjen e kontabilitetit;
 - f) menaxhimin e risigurimeve dhe marrëdhëniet me siguruesit e jashtëm.
3. Funkcionet e siguruesit mund të delegohen vetëm nëpërmjet një kontrate të shkruar, në bazë të së cilës Siguruesi transferon një pjesë të funksioneve të tij tek një person tjetër/pranuesi i funksioneve të deleguara.
4. Siguruesi duhet të sigurohet se delegimi i funksioneve:
- a) nuk cenon rezultatet financiare dhe stabilitetin e siguruesit si dhe vazhdimësinë e aktiviteteve të tij;
 - b) nuk cenon cilësinë e menaxhimit dhe vendim marrjes së siguruesit;
 - c) nuk cenon aftësinë e siguruesit për t'ju ofruar të siguruarve një shërbim të vazhdueshëm;
 - d) nuk krijon një rritje të pajustificuar të rreziqeve operacionale.
5. Siguruesi përpara përzgjedhjes së pranuesit të funksioneve të deleguara, duhet:
- a) të sigurohet se pranuesi i funksioneve të deleguara është i aftë dhe i përshtatshëm për t'i kryer funksionet e deleguara;
 - b) të kryej një analizë të detajuar të aftësisë dhe kompetencës profesionale të pranuesit të funksioneve të deleguara;
 - c) të sigurohet që pranuesi i funksioneve të deleguara ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e konfliktit të interesit;

Neni 4

Politikat për delegimin e funksioneve

1. Siguruesi, duhet të hartojë dhe miratojë politika të brendshme për delegimin e funksioneve. Politikat e tilla duhet të përfshijnë së paku, elementet si në vijim:
- a) identifikimin e funksioneve që do të delegohen, dhe vlerësimin e ndikimit që do të ketë delegimi i atyre funksioneve;
 - b) procedurat për delegimin e funksioneve, përfshirë kriteret për përzgjedhjen e pranuesit të funksioneve të deleguara;
 - c) afatet dhe metodat e raportimit të pranuesit të funksioneve të deleguara, tek siguruesi;
 - d) mënyrat e monitorimit të pranuesit të funksioneve të deleguara, nga ana e siguruesit;
 - e) përcaktimin e tarifave të aplikueshme për funksionet e deleguara.

Neni 5

Kontrata e delegimit të funksioneve

1. Kontrata e delegimit të funksioneve ndërmjet siguruesit dhe pranuesit të funksioneve të deleguara, duhet të përmbajë sa më poshtë:
- a) të drejtat dhe detyrimet e palëve;
 - b) një dispozitë e cila përcakton se siguruesi që delegon përgjegjësinë është përgjegjëse për funksionet e transferuara tek personi tjetër dhe, në asnjë rast, nuk shmang përgjegjësitë e organeve drejtuese të siguruesit.

- c) një dispozitë e cila përcakton se pranuesi i funksioneve të deleguara është i obliguar t'i ofroj siguruesit informacionet e kërkuara sipas nenit 6, paragrafi c);
- d) angazhimin e personit të deleguar për të kryer veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat rregullatore si dhe politikat e miratuara nga siguruesi dhe për të bashkëpunuar me BQK-në për sa i përket funksioneve të deleguara;
- e) dispozitë që përcakton se personi pranues i funksioneve të deleguara, do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes nga ana e BQK-së;
- f) detyrimin e personit të deleguar për të informuar menjëherë siguruesin për çdo fakt që mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në aftësinë e tij për të kryer në mënyrë efikase dhe efektive veprimtarinë e tij sipas kërkesave ligjore në fuqi;
- g) një periudhë njoftimi për përfundimin e kontratës nga ana e personit të deleguar, e cila është e mjaftueshme për siguruesin të gjejë një zgjidhje alternative;
- h) të drejtën e siguruesit për t'u informuar në lidhje me mbarëvajtjen e funksioneve të deleguara nga personi i deleguar, si dhe të drejtën e siguruesit për të hartuar dhe miratuar udhëzime të përgjithshme apo të veçanta në lidhje me kryerjen e funksioneve të deleguara;
- i) ruajtjen e konfidencialitetit nga ana e personit të deleguar, të të dhënave që lidhen me siguruesin dhe me të siguruarin;
- j) të drejtën e siguruesit për t'u tërhequr nga kontrata, nëse kjo e fundit kërkohet nga BQK-ja për shkaqe të mosrespektimit të kriterëve ligjore.

Neni 6

Kërkesat për miratimin e delegimit të funksioneve

1. Siguruesi duhet të bëjë kërkesë me shkrim në BQK, përmes të cilës kërkon miratimin e funksioneve të deleguara. Kërkesa për miratim të funksioneve të deleguara duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) vendimin e bordit të drejtoreve të siguruesit përmes të cilit është vendosur delegimi i funksioneve;
 - b) përshkrimin e funksioneve që siguruesi kërkon të delegojë, si dhe kushtet që duhet të përmbushë pranuesi potencial i funksioneve të deleguara, si dhe kohëzgjatjen e delegimit të funksioneve;
 - c) të dhëna mbi pranuesin potencial të funksioneve të deleguara, si: emrin, certifikatën e regjistrimit të biznesit, kualifikimet, raportet financiare për tri vitet e fundit (nëse janë të aplikueshme sipas legjislacionit në fuqi për raportim financiar), si dhe të dhëna të tjera në rastet e personave potencial të deleguar nga një vend i huaj: adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e e-mailit, faqen zyrtare, emrin, mbiemrin dhe detaje të kontaktimit të personit të autorizuar për përfaqësim të pranuesit të funksioneve të deleguara; në rastin kur pranuesi i funksioneve të deleguara është person i jashtëm, përveç të dhënave të lartpërmendura në këtë nënparagraf, BQK-ja, sipas vlerësimit të saj, mund të kërkojë edhe të dhëna të tjera.

- d) rezultatet e analizave dhe vlerësimeve të kryera nga siguruesi sipas përcaktimeve të nenit 3, paragrafi 5, nënparagrafi b) të kësaj rregulloreje;
- e) drafti i kontratës me përmbajtje sipas përcaktimeve të nenit 5 të kësaj rregulloreje;
- f) dokumente që vërtetojnë përvojën e pranuesit të funksionit të deleguar për aktivitetet e njëjta me funksionin e deleguar nga siguruesi (nëse ka);
- g) dokumentacion që vërteton çdo përvojë tjetër të pranuesit të funksionit të deleguar.

Neni 7

Miratimi ose refuzimi i funksioneve të deleguara

1. BQK-ja, brenda afatit prej 30 ditë kalendarike nga pranimi i kërkesës, miraton ose refuzon kërkesën për miratim të funksioneve të deleguara.
2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, BQK-ja mund të kërkojë nga siguruesi, dokumentacion dhe informata shtesë. Në raste të tilla, afati prej 30 ditëve fillon të rrjedh nga momenti kur dokumentacioni dhe informatat shtesë pranohen në BQK.
3. BQK-ja refuzon delegimin e funksioneve të veçanta të siguruesit nëse nuk përmbushen kërkesat e parashikuara në Ligjin për Sigurime dhe në këtë rregullore.

Neni 8

Tërheqja e miratimit të funksioneve të deleguara

BQK-ja mund ta tërheq miratimin e funksioneve të deleguara nëse vlerëson se ushtrimi më tutje i funksioneve të deleguara nga pranuesi i tyre, rrezikon interesat e policëmbajtësve, vështirësohet mbikëqyrja nga ana e BQK-së dhe pranuesi i funksioneve të deleguara nuk ka kompetence profesionale për të ushtruar funksionin e deleguar.

Neni 9

Mbikëqyrja e funksioneve të Deleguara

1. Dispozitat e Ligjit për Sigurime mbi mbikëqyrjen e siguruesve, zbatohen përshtatshëmrisht edhe për mbikëqyrjen e pranuesit të funksioneve të deleguara.
2. Siguruesi dhe pranuesi i funksioneve të deleguara, me kërkesën e BQK-së paraqet të dhëna mbi statusin juridik, gjendjen financiare dhe veprimtarinë e personit juridik, i cili ka nënshkruar kontratën për delegimin e funksioneve të veçanta, si dhe çdo dokument dhe informacion tjetër të kërkuar nga BQK-ja.
3. Auditori i jashtëm i siguruesit ka të drejtë t'i kërkojë pranuesit të funksioneve të deleguara çdo informacion që lidhet me kryerjen e auditimit.
4. Pranuesi i funksioneve të deleguara, duhet të bashkëpunojë me BQK-në në lidhje me mbikëqyrjen e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 10

Zbatimi, Masat Përmirësuese dhe Dënimet Civile

Çdo shkelje e dispozitave të tjera të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjit nr.05/L-045 për Sigurimet.

Neni 11

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregulli 18 mbi Anëtarësimin dhe Kontratat e Jashtme, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci